



KONFERENCA
Diaspora Flet

ANALIZË E SHKURTËR E POLITIKAVE MBI
PËRFAQËSIMIN E DIASPORËS
NË INSTITUCIONET
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Germin dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

© 2018 Germin

Pa lejen me shkrim nga Germin asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rrikthimi, të transmetohet në ndonjë formë ose me çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjimi, incizimi ose ndryshe.

Prishtinë, 2018

Analizë e shkurtër e politikave për përfaqësimin e Diasporës në institucione

I. Situata aktuale

Roli dhe potenciali i diasporës është duke marrë çdo ditë e më shumë vëmendje nga politikëbërësit, hulumtuesit dhe publiku dhe më shumë hapësirë në strategjitë zhvillimore të vendeve të ndryshme. Krijimi i lidhjeve në mes të pjesëtarëve të diasporës dhe institucioneve të vendit/shtetit të origjinës është proces që kërkon angazhim dhe përkushtim të veçantë. Mënyra e qasjes ndaj një procesi të tillë është përcaktuese e nivelit të angazhimit dhe përfshirjes së diasporës në institucionet e shtetit dhe proceset tjera shoqërore të vendit të prejardhjes. Angazhimi do të thotë përfshirja, pjesëmarrja dhe madje influencimi i dikujt. Në rastin e angazhimit të diasporës, zakonisht supozohet se është një shtet apo qeveri që kërkon të angazhohet komuniteti i njerëzve që jetojnë jashtë vendit, ose të cilët janë emigrantë ose pasardhës të emigrantëve dhe që ndajnë një afinitet ose mbajnë lidhje me të. Angazhimi mund të nënkuptojë gjithashtu të filluarit dhe të përfunduarit e një aktiviteti, pjesëmarrja apo përqëndrimi i vëmendjes te diçka. Në këtë kontekst, angazhimi i diasporës mund, për shembull, të përkthehet në njohjen dhe përfshirjen e diasporës në aktivitetet zhvillimore.[1]

Kosova, më shumë se shtetet e rajonit, ka gëzuar angazhimin dhe vëmendjen diasporës, edhe në mungesë të politikave madje edhe në mungesë të institucioneve përkatëse. Përparësia krahasuese e Kosovës në këtë drejtim, në raport me vendet tjera, janë lidhjet akoma shumë të forta të pjesëtarëve të diasporës me atdheun e tyre. Por, pavarësisht kësaj, Republika e Kosovës akoma nuk ka arritur që lidhjet dhe angazhimin e deritanishëm më shumë vullnetar dhe individual të pjesëtarëve të diasporës, ta shndërrojë në ndërmarrje të organizuar duke njohur dhe institucionalizuar kontributin dhe pjesëmarrjen e tyre në funksion të zhvillimit të vendit.

Kjo analizë do të trajtojë angazhimin e diasporës përmes përfaqësimit në institucionet shtetërore. Duke adresuar vështirësitë kyçe të politikave të përfaqësimit dhe angazhimit të diasporës në institucionet vendore dhe duke marrë shembujt më të mirë të shteteve të tjera,

kjo analizë synon të nxjerrë format apo mënyrat më të përshtatshme të përfaqësimit të diasporës në institucionet e Republikës së Kosovës. Rekomandimet nga ky dokument, u drejtohen, me theks të veçantë, politikëbërësve vendor, pjesëtarëve të diasporës, si dhe palëve të tjera të interesuara në procesin e angazhimit të diasporës në proceset zhvillimore të vendit.

II. Definimi i Diasporës

Gjatë përpilimit të çfarëdolloj strategjie apo politike mbi angazhimin e diasporës, pyetja e parë që duhet t'i përgjigjemi është "çka nënkuptohet me, dhe kush e përbën diasporën"? Fjala diaspora vjen nga greqishtja, *dia* që do të thotë përmes/nëpërmjet' ose 'mbi/përmbi' dhe *speiro* që do të thotë 'shpërndarje' ose 'mbjellje'.^[2] Diaspora është e përbërë nga ajo pjesë e njerëzve, të shpërndarë në një ose më shumë vende jashtë atdheut por që mbajnë ndjenjën e një komuniteti trans-nacional të lidhur me vendin e origjinës.^[3] Gerard-Francois Dumont, e përkufizon diasporën si "*një bashkësi të individëve që jetojnë së bashku në të njëjtin territor dhe që kanë të përbashkët bindjen ose besimin e përkatësisë, të vetes ose familjeve të tyre në një territor tjetër me të cilin ata mbajnë marrëdhënie të rregullta.*"^[4]

Por, përdorimi në rritje i nocionit 'diaspora' vjen si pasojë e politizimit të tij, si përshkrues më specifik i emigrantëve dhe pasardhësve të tyre si agjentë zhvillimi. Nocioni i diasporës nuk i përfshin të gjithë emigrantët. Diaspora u referohet kryesisht individëve apo grupeve të integruara në shtetet pritëse të cilët kanë ndjenjën e përkatësisë me bashkëkombasit dhe vazhdojnë të mbajnë lidhje me shtetin e origjinës.

Në legjisllacionin e Kosovës, diaspora definohet përmes Ligjit Nr. 04/L - 095, Neni 2, pika 1.1, ku thuhet se pjesëtar i diasporës është "*çdo person që ka vendbanim apo vendqëndrim jashtë Republikës së Kosovës dhe që ka lindur apo ka prejardhje familjare nga Kosova.*"^[5] Në këtë ligj por edhe në Strategjinë Kombëtare për Diasporën, vërejmë se nuk përcaktohet periudha apo koha e qëndrimit jashtë vendit për t'u kualifikuar si pjesëtar i diasporës, dhe përdoren dy terma: diaspora dhe mërgata, dallimi i të cilave nuk shpjegohet. Në definimin e termit, nevojitet të trajtohet edhe përkatësia kombëtare e pjesëtarëve të diasporës. Ish-ministri i diasporës, Z. Valon Murati thotë se diaspora e Kosovës në aspektin juridik mund të konsiderohet si e Kosovës, dhe nuk përjashton asnjë shtetas të Kosovës jashtë vendit, përfshirë pakicat kombëtare. Mirëpo shumica e saj politikisht, kulturalisht dhe gjuhësisht është pjesë e diasporës shqiptare. Rrjedhimisht diaspora shqiptare përfshin të gjithë shqiptarët jashtë vendit pa dallim shtetësie. Në funksion të kësaj diaspora shqiptare është një dhe e pandarë dhe si të tillë e

trajton edhe Republika e Kosovës.[6] Edhe pse llogaritet se pjesëtarë të diasporës me shtetësi kosovare janë rreth 700,000 (përfshirë pakicat kombëtare) [7], shqiptarët jo-shtetas të Kosovës janë shumë më shumë në numër dhe rëndësia e përfshirjes së tyre qëndron në faktin se ata historikisht kanë kontribuar në lirinë dhe pavarësinë e Kosovës dhe edhe sot vazhdojnë të jenë të gatishmi për angazhim në Kosovë dhe lidhur me të.

III. Rëndësia e angazhimit të diasporës

Përmes remitançave, transferimit të vlerave dhe ideve, diaspora luan një rol shumë të rëndësishëm në shtetndërtim dhe zhvillim. Përtej ndjenjës së përkatësisë dhe kultivimit të politikave që kanë për qëllim ruajtjen e identitetit kombëtar të pjesëtarëve të diasporës, shteti i Kosovës duhet të trajtojë diasporën si një aset të çmueshëm me potencial të madh të ndryshimeve pozitive dhe agjent të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Ish-ministri Murati thekson se përtej lidhjeve etno-kulturore, angazhimi i diasporës është çështje e interesit kombëtar.[8] Kosova, deri tani ka kaluar dhe është në proces, në disa hapa fillestar, të krijimit të kushteve për angazhimi të diasporës.

Së pari, njohja e diasporës – një proces i cili ka të bëjë me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave mbi diasporën me qëllim krijimin e një pasqyre të saktë mbi pjesëtarët e diasporës. Në këtë drejtim, Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm me Regjistrin e Diasporës dhe Mërgatës, një projekt që është duke vazhduar dhe që përfshinë shoqatat, bizneset dhe të gjitha organizimet e tjera jashtë vendit.

Së dyti, institucionalizimi i veprimeve për diasporën – proces i cili nënkupton krijimin e mekanizmave institucionalë që krijojnë dhe hartojnë politika për diasporën. Edhe në këtë çështje, Republika e Kosovës ka avancuar duke formuar Ministrinë për Diasporën, duke miratuar Ligjin për Diasporën dhe Mërgatën, përfshirjen e diasporës në Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme, si dhe krijimin e pozitës së zyrtarit komunal për çështje të diasporës dhe mërgatës në nivelin lokal. Por, këto janë të pamjaftueshme duke pasur parasysh potencialin dhe madhësinë e diasporës. Mbi 200 organizata dhe mbi 300 aktivitete/ngjarje në vit të evidentuara vetëm nga platforma www.diasporaflet.org janë tregues se gjendja aktuale nuk përfill kërkesat e diasporës dhe se përfaqësimi i saj në institucionet e Kosovës është joproportional.

IV. Përfaqësimi i diasporës

Realizimi i të drejtave politike

Angazhimi i diasporës nuk mund të arrihet pa realizimin e të drejtave politike të cilat përfshijnë: mundësinë për të zgjedhur (votuar) dhe për t'u zgjedhur. Me legjislacionin aktual, Republika e Kosovës obligohet përmes Kushtetutës për "mbrojtjen e interesave të shtetasve që jetojnë jashtë vendit"[9] dhe poashtu përmes nenit 45 garantohet e drejta zgjedhore dhe e pjesëmarrjes për të gjithë shtetasit brenda dhe jashtë vendit. Por, praktikisht vërehet pjesëmarrje shumë e ulët në realizimin e të drejtës për të votuar dhe mungesë mekanizmash që e lehtësojnë pjesëmarrjen në zgjedhje. Nga rreth 20.000 aplikacione për votim nga jashtë në zgjedhjet e fundit parlamentare (2017), vetëm rreth 5.000 janë numëruar si vota të vlefshme. Përveç interesit jo të lartë për të votuar, vështirësitë e mënyrës së votimit *përmes postës* kanë ndikuar që pjesëmarrja të jetë e ultë. Në këtë drejtim, siç sugjeron edhe ish-ministri Murati, Kosova duhet ta shqyrtojë seriozisht mënyrën e votimit *në person*, duke organizuar procesin e votimit në ambasada dhe konsullata.[10] Ky opsion përdoret nga 55 vende dhe ka si përparësi sigurimin e fshehtësisë së votës dhe mundësinë për dalje më të madhe në zgjedhje, por në anën tjetër është i kushtueshëm për t'u organizuar.[11]

Përfaqësimi direkt (rezervimi i ulëseve në parlament)

Pjesëmarrja e diasporës në proceset politike dhe socio-ekonomike varet edhe nga niveli i përfaqësimit apo ndikimit të saj në institucionet më të larta përfaqësuese siç është parlamenti apo qeveria. Në mungesë të realizimit të së drejtës për t'u zgjedhur, diaspora është e hendikepuar në kuptimin e realizimit të të drejtave politike. Disa shtete në botë, 5 prej tyre në Evropë (Franca, Italia, Kroacia, Maqedonia dhe Portugalia), kanë krijuar ulëse të veçanta në parlament për përfaqësuesit e diasporës. Për qëllimet e kësaj analize do të trajtojmë modelin Kroat[12] dhe modelin Portugez [13] të përfaqësimit të diasporës në parlament.


Modeli **KROAT**



4 MILION
vlerësohet të jetë
numri i
pjesëtarëve të
diasporës kroate



1995 - nga ky vit
Kroacia ka
integruar
diasporën në
sistemin zgjedhor



ZONA 11 - është
zonë e veçantë
zgjedhore për
diasporën (nga
12 në total)



12 - është numri
maksimal i
ulësve për
diasporën në
parlament

36% është pjesëmarrja në
votime nga diaspora në zgjedhjet
e fundit (2016). Nga 59.418 votues
të regjistruar kanë votuar 21.208

3 deputetë janë aktualisht të
zgjedhur nga zona 11, si
përfaqësues të diasporës nga
zgjedhjet e fundit (2016)



- o Modeli kroati mundëson përfaqësim proporcional në raport me pjesëmarrjen në votime
- o Aplikimi i votimit 'në person' siguron fshehtësinë e votës dhe lehtëson procesin e votimit
- o Votimi organizohet në 140 përfaqësi diplomatike kroate




- o Numri i deputetëve varet direkt nga pjesëmarrja në zgjedhje. Mund të krijohet nënpërfaqësim me numrin e përgjithshëm të diasporës
- o Ka kosto të lartë të organizimit për shkak të distancës së qendrave të votimit

Modeli **PORTUGEZ**



1975 - nga ky vit Portugalia ka integruar diasporën në sistemin zgjedhor



2 zona zgjedhore për diasporën (nga 22 gjithsej). Njëra për Evropën dhe tjetra për vendet tjera



4 - është numri maksimal i ulësve për diasporën në parlament



55 mijë është pragu minimal i daljes në votime për zonat zgjedhore të diasporës

Diaspora përfshihet në një zonë të vetme kur votohet për presidentin, për referendum apo për zgjedhjet evropiane - votimi 'në person'

Votimi përmes postës aplikohet në zgjedhjet legjislativë. Diaspora portugeze nuk mund të votojë në zgjedhjet lokale



- o Mundësia e ndikimit përmes votës në institucionet e nivelit qendror, zgjedhja e presidentit.
- o Mundësia e zgjedhjes së eurodeputetëve nga ana e të gjithë portugezëve (pavarësisht ku jetojnë) jashtë vendit.



- o Numri i deputetëve fiks - nuk varet direkt nga pjesëmarrja në zgjedhje.
- o Votimi përmes postës, pak i kushtueshëm por ngrit dyshime mbi fshehtësinë e votës

Në mes këtyre dy modeleve, përfaqësimi direkt të diasporës së Kosovës do t'i shkonte për shtati më së shumti modeli kroat, ku me një zonë të veçantë zgjedhore do të ri-organizohej edhe procesi i votimit dhe përfaqësuesit e diasporës do të kishin legjitimitet të plotë. Por, ashtu siç thuhet në Strategjinë Kombëtare për Diasporën[14], gjë të cilën e pohon edhe ish-ministri Murati, përfaqësimi direkt i diasporës në Kuvend kërkon ndryshime kushtetuese dhe se kjo duket e pamundur në plan afatmesëm, edhe pse Ministria e Diasporës i ka bërë një kërkesë komisionit parlamentar për reformën kushtetuese dhe zgjedhore që diasporës t'i rezervohen 5 vende në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Përfaqësimi indirekt (Organizmat këshilldhënëse/avokuese)

Përveç përfaqësimit direkt në parlament, shumë shtete kanë krijuar Këshille apo Asamble të Diasporës të cilat kanë rol këshilldhënës dhe avokojnë politika pranë qeverive kombëtare. Këto organizma shpesh kanë rezultuar më efektive se përfaqësimi në parlament. Për shembull, Kroacia ka krijuar Këshillin e Kroatëve jashtë Republikës së Kroacisë[15], një organ gjithëpërfshirës i cili përbëhet nga 55 anëtarë dhe shërben si trupë këshilluese/asistuese për qeverinë në çështje të lidhura me diasporë, por jo vetëm. Ky këshill përbëhet nga përfaqësuesit e organizatave, institucioneve dhe asociacioneve jashtë vendit, personat me ndikim brenda dhe jashtë komuniteteve të tyre të cilët emërohen nga qeveria kroate me propozim të komuniteteve të vendeve ku ata jetojnë. Anëtarët zgjedhen në bazë të rëndësisë së kroatëve në vendin përkatës, lidhjet e atij komuniteti me shtetin kroat, dhe afirmimin e interesave të Kroacisë.

Një shembull tjetër është Armenia, njëra nga vendet me diasporën më të madhe në botë, e cila përveç të tjerash ka krijuar fondin gjithë-armenian të quajtur "Hayastan", i kryesuar nga Presidenti i Republikës së Armenisë. Çdo tre vjet, Ministria Armene e Diasporës organizon konferencën 'Armenia dhe Diaspora' për të diskutuar çështje të interesit kombëtar.[16] Ky fond ka arritur që të avokojë politika të fushave të ndryshme, dhe në bashkëpunim me qeverinë armene, të implementojë shumë projekte në shërbim të armenëve brenda dhe jashtë. Pjesëmarrja në këtë fond është vullnetare, por aktivitetet e tij janë të institucionalizuara dhe koordinohen nga Presidenti. Përfaqësimi indirekt i diasporës përmes këtyre organizmave, mundëson që të rritet ndikimi në të gjitha nivelet e pushtetit duke filluar nga qeveria, parlamenti, komunat, etj. Përparësi e kësaj forme është fleksibiliteti në organizim si dhe mundësia më e madhe e përfshirjes/angazhimit të sa më shumë pjesëtarëve të diasporës dhe bashkimit të potencialit të tyre. Unifikimi i diasporës është çështje e interesit kombëtar, prandaj

formimi i një trupe gjithëpërfshirëse do të rriste mundësitë për interaktivitet të diasporës me shtetin amë por edhe ndikimit në zhvillim ekonomik dhe shoqëror. Përparësi tjetër e kësaj forme organizimi është mundësia e përfshirjes së personaliteteve me famë/ndikim botëror nga bota shqiptare të cilët do të rrisnin kapacitetet influencuese të Këshillit si brenda ashtu edhe jashtë.

V. Rekomandime

1. Të ndërmerren masa për rritjen pjesëmarrjes së diasporës në zgjedhje. Të rishikohet forma aktuale e votimit *përmes postës* dhe të thjeshtëzohen procedurat e regjistrimit për votuar duke mundësuar regjistrimin *online*, përmes një web-platforme nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Të trajtohet mundësia e votimit *në person* dhe orgnizimit të zgjedhjeve nëpër ambasadat dhe konsullatat e Republikës së Kosovës. Të informohen saktë dhe në kohë pjesëtarët e diasporës rreth të gjitha procedurave që lidhen me zgjedhjet, pasi që vazhdimisht ka pasur ankesa për mungesë të informimit adekuat;
2. Përkundër faktit se ndryshimi i Kushtetutës së Kosovës është shumë i vështirë, për shkak të së drejtës së vetos që kanë pakicat, dhe e cila po shfrytëzohet nga përfaqësuesit e pakicës serbe deri më tani në të gjitha përpjekjet për të ndryshuar kushtetutën (bllokimi i formimit të ushtrisë është rasti më aktual), të shterren të gjitha mundësitë juridike dhe politike për adresimin e përfaqësimit direkt të diasporës në parlament. Ministria e Diasporës të kërkojë nga të gjitha instancat relevante, mundësitë e futjes së kësaj çështje në projektligjin e ri për ndryshimin e Ligjit për Diasporën, përfshirë këtu edhe hapat e nevojshëm për ndryshimet kushtetuese. Të informohen pjesëtarët e diasporës nga Ministria për ecurinë e këtij procesi. Përfaqësimi i diasporës në Kuvendin e Kosovës do të rriste edhe më tej angazhimin e diasporës, do të tregonte vlerësimin që shteti i Kosovës ua jep bashkëkombasve të vet, si dhe do të rriste mundësitë për rritjen e remitancave sociale në Republikën e Kosovës;
3. Të iniciohet formimi i Këshillit Kombëtar të Diasporës. Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë dhe përfaqësuesit politik të shqiptarëve në Maqedoni, Mal të Zi, Serbi dhe përfaqësuesit nga diaspora, të organizojnë një konferencë për unifikimin e diasporës shqiptare në një institucion gjithëpërfshirës me karakter konsultativ. Këshilli Kombëtar i Diasporës do të përbëhej vetëm nga pjesëtarët

e diasporës. Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës të zotohen për financimin e një trupe organizative (sekretariat) të Këshillit, si dy shtetet me shumicë shqiptare. Për financimin e këtij mekanizmi do të duhej të diskutohej edhe me qeverinë e Republikës së Maqedonisë;


4. Në hartimin e strategjisë së re për diasporën dhe ndryshimet në legjislacionin aktual, të trajtohet me vëmendje të veçantë çështja e definimit të diasporës. Të përcaktohen qartë specifikat e kualifikimit të qytetarëve si anëtarë të diasporës si dhe të përcaktohet dallimi midis diasporës dhe mërgatës. Në këtë drejtim, gjatë ndryshimit të Ligjit për Diasporën nga Qeveria, të shqyrtohet mundësia e largimit nga përdorimi në emërtim të termit mërgata, në mënyrë që të mos krijohen paqartësi kur i referohemi diasporës, ose të jepet shpjegim i qartë cili është dallimi midis tyre.

VI. Referencat:

- [1] Malin Frankenhaeuser & Marion Noack. "Promoting Diaspora Engagement what have we learnt?", faqe 5. https://www.icmpd.org/fileadmin/ICMPD-Website/ICMPD_General/Publications/2015/Promoting_Diaspora_Engagement.pdf
- [2] Kingsley Aikins & Nicola White. "Global Diaspora Strategies Toolkit: Harnessing the power of global diasporas", faqe 8. <http://diasporamatters.com/wp-content/uploads/2016/02/Diaspora-Toolkit-Book.pdf>
- [3] Po aty.
- [4] Andrea Rigoni, Democratic participation for migrant Diasporas, Report of Committee on Migration, Refugees and Displaced Persons, Council of Europe, 2013. Faqe 5. <http://website-pace.net/documents/19863/168397/20141127-RigoniDiaspora-EN.pdf/e089137f-444a-4ed8-9bf9-bb393a2c4ab6>
- [5] Ligji Nr. 04/L - 095 PËR DIASPORËN DHE MËRGATËN, Neni 2, pika 1.1 <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20diasporen%20dhe%20mergaten.pdf>
- [6] Intervistë me ish-Ministrin e Diasporës së Republikës së Kosovës, Z. Valon Murati, 20 Mars 2018.
- [7] Raporti i ASK-së "Migrimi Kosovar", Prishtinë: 2014 <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/agjencia-e-statistikave-se-kosoves-ask-per-here-te-pare-ka-dale-me-raportin-migrimi-kosovar>
- [8] Intervistë me ish-Ministrin e Diasporës së Republikës së Kosovës, Z. Valon Murati, 20 Mars 2018
- [9] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 15.
- [10] Intervistë me ish-Ministrin e Diasporës së Republikës së Kosovës, Z. Valon Murati, 20 Mars 2018
- [11] QPA. DIASPORA: PËR NJË PËRFAQËSIM TË DREJTË NË VENDIMARRJE, faqe 16. <http://qpa-rks.org/web/wp-content/uploads/2015/02/Perfaqesimi-i-Diaspores-ne-vendimmarrje.pdf>
- [12] Ligji mbi Zgjedhjen e Përfaqësuesve në Parlamentin Kroat, Neni 41. <http://www.sabor.hr/Default.aspx?art=16934>
- [13] Andy Sundberg: Diasporas Represented in Their Home Country Parliaments, Prepared Andy Sunberg based on information from, Voting from Abroad: The International IDEA Handbook, 2007, fq. 12., https://www.overseasvotefoundation.org/files/Diasporas_Represented_in_their_Home_Country_Parliaments.pdf
- [14] Qeveria e Republikës së Kosovës: Strategjia Për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018. Faqe 16. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Diasporen_dhe_plani_i_veprimit_2013-2018.pdf
- [15] Këshilli i Republikës së Kroacisë për Kroatët jashtë vendit. <http://www.hrvatiizvanrh.hr/en/hmiu/action-relations-of-the-republic-of-croatia-with-croats-abroad/47>
- [16] Fondi gjithë-armenian "Hayastan". <http://www.himnadram.org/en/>



MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).